



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 777  
Dt 08.06.2020

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, dhe nenit 153, paragrafi 2 të Statutit të Përkohshëm, si dhe nenit 17, paragrafi 3 të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 5.6.2020, mori:

**VENDIM**

- I. Rikthehet për rishqyrtim propozimi i Këshillit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore për përzgjedhjen e kandidatit Florent Dobrosi në pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit (O), Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (O), Projektimi i proceseve në inxhinierinë kimike (O), Inxhinieria elektronike (O), Teknologjia inorganike (Z), Përgatitja e ujit në industri (Z)", në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Obligohet Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore që, lidhur me publikimet shkencore, të rishqyrtojë edhe një herë dosjen e kandidatit të përmendur, për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit (O), Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (O), Projektimi i proceseve në inxhinierinë kimike (O), Inxhinieria elektronike (O), Teknologjia inorganike (Z), Përgatitja e ujit në industri (Z)", në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit (O), Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (O), Projektimi i proceseve në inxhinierinë kimike (O), Inxhinieria elektronike (O), Teknologjia inorganike (Z), Përgatitja e ujit në industri (Z)", në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore. Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 5.6.2020, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit të Studimeve për rishqyrtim të propozimit të Këshillit të Fakultetit lidhur me publikimet shkencore të kandidatit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakultetit;

Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it

